

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Raporti përcjellës i monitorimit të kuvendeve
komunale
janar – dhjetor 2011

Qershor 2012

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. HYRJE	4
2. MBLEDHJET E KUVENDEVE KOMUNALE – GJETJET KRYESORE	5
2.1 Njoftimi për mbledhjet	5
2.2 Parandalimi i konfliktit të interesit.....	7
2.3 Sigurimi i përkthimit me shkrim dhe me gojë.....	8
2.4 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – veprimtaritë e mbikëqyrjes...	9
3. PËRFUNDIMET	10
4. REKOMANDIMET	11

Përmbledhje ekzekutive

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje si dhe mbikëqyrja e institucioneve lokale janë parime themelore të qeverisjes së mirë të sajuara për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të proceseve demokratike. *Raporti monitorues përcjellës për kuvendet komunale* (janar – dhjetor 2011), ashtu si edhe botimet e mëhershme të botuara nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE), vlerëson – në sfond të respektimit të Ligjit për vetëqeverisjen lokale – ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës së kuvendeve komunale në lidhje me njoftimin publik për mbledhjet e kuvendeve komunale, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve komunalë, përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe mbikëqyrjen e qeverisë qendrore në lidhje me respektimin e tyre nga niveli komunal.

Në përgjithësi është shënuar përparim në respektimin e dispozitave ligjore nga ana e kuvendeve komunale. Njoftimi me kohë i opinionit për mbledhjet e kuvendeve komunale përbushet nga 91 për qind e komunave; prej tyre, 44 për qind ndërmorën nisma shtesë për të përfshirë qytetarët, duke vendosur praktikën më të mira që mund të përsëriten në tërë Kosovën. Në dy komuna, procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve komunalë janë qartë të përcaktuara në statutet e komunës dhe rregulloret e punës të kuvendit. Për më tepër, me futjen në përdorim të transmetimit të seancave të kuvendeve komunale përmes ueb kamerës në janar të vitit 2012, zyrtarët e nivelit qendror nuk kanë nevojë që të jenë më fizikisht të pranishëm në mbledhjet e kuvendeve komunale. Angazhimi i qeverisë për të mundësuar transmetimin elektronik (*online*) të seancave të kuvendeve komunale në të ardhmen, është një nismë e shkëlqyeshme që pritet të shtojë transparencën dhe llogaridhënien.

Sidoqoftë, ende ka mangësi në disa komuna. Së pari, ka rënë numri i komunave që ndërmorën masa për të adresuar situatat e konfliktit të interesit. Së dyti, në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare – ndonëse u siguroa gjerësisht përkthimi me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendit komunale – obligimi për përkthimin e procesverbaleve të mbledhjeve në të gjitha gjuhët zyrtare në një komunë të dhënë nuk respektohet në mënyrë të përpiktë.

Në mënyrë që të përmirësojë edhe më tej transparencën dhe llogaridhënien e proceseve legislative komunale, Misioni rekomandon si në vijim: shtimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në mbledhjet e kuvendeve komunale, për shembull përmes njoftimeve në vende publike dhe/ose duke i shpallur ato përmes mediave lokale; përkufizimin e procedurave për mbikëqyrjen e gjendjeve të konfliktit të interesit dhe sigurimin e asaj se ato respektohen; përkthimin dhe publikimin e procesverbaleve të kuvendeve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare si dhe mundësimin e transmetimit publik nëpërmjet ueb faqes të mbledhjeve të kuvendeve komunale.

1. HYRJE

Korniza ligjore dhe rregullatore¹ në Kosovë, posaçërisht Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, përkufizon kërkesat për funksionimin e kuvendeve komunale dhe përcakton garancitë për të siguruar pjesëmarrjen e opinionit në proceset e vendimmarrjes. Kjo përfshin kërkesat për takimet e hapura të kuvendeve komunale, si dhe njoftimin e opinionit për takimet e tilla dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare. Për më tepër, dispozitat që adresojnë situatat e konfliktit të interesit synojnë që të sigurojnë respektimin e standardeve ndërkombëtare, të tilla si parimet e qeverisjes së mirë në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien. Zbatimi i duhur i kësaj kornize rregullatore do të sigurojë se qeveritë lokale veprojnë në pajtim me këto parime thelbësore. Niveli i respektimit të këtyre parimeve nga ana e komunave mbikëqyret nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si një autoritet mbikëqyrës i nivelit qendror, që cakton zyrtarët për mbikëqyrjen e mbledhjeve të kuvendeve komunale.²

Në këtë raport paraqiten informatat më të reja ndaj botimit të vitit 2011 për vështirimin e aspekteve kyçe të punës së kuvendeve komunale, si dhe për zhvillimet në lidhje me mekanizmat e mbikëqyrjes të ministrisë në nivel komunal. Ai mëton t'i shërbejë përfaqësuesve të komunës, ministrisë dhe hisedarëve të tjerë gjegjës të përfshirë në çështjet e qeverisjes lokale si një lloj treguesi për zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve në nivel lokal. Raporti është i përqendruar në përdorimin e rasteve të identifikuar të praktikave më të mira nga komunat e tjera, me anë të bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe trajnimit.

Ky vlerësim mbulon 362 mbledhje të kuvendeve komunale që u mbajtën në 34 komuna³ gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2011. Të dhënat u mblodhën nga OSBE-ja nëpërmjet monitorimit të zakonshëm të veprimtarive komunale, si dhe me anë të intervistave të strukturuar me zyrtarët e nivelit komunal dhe atij qendror.

Raporti është i përqendruar në tri aspekte kryesore të respektimit, si dhe në mbikëqyrjen e veprimtarive të kuvendeve komunale. Në pjesën e dytë paraqiten gjetjet përkritazi me njoftimin për mbledhjet e kuvendeve komunale, parandalimin e situatave të konfliktit të interesit, nivelin e respektimit të dispozitave ligjore për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe zhvillimet dhe përpjekjet më të reja në lidhje me veprimtaritë mbikëqyrëse të ministrisë. Raporti përfundon me rekomandimet për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies të qeverisjes në nivel komunal.

¹ Korniza ligjore përfshin standardet që burojnë nga Karta evropiane për vetëqeverisje lokale dhe protokollet e saja (në tekstin e mëtutjeshëm: Karta).

² Si një autoritet mbikëqyrës, ministria ka krijuar një sistem të mbikëqyrjes që i mundëson asaj identifikimin e mangësive përkritazi me ligjshmërinë e veprimtarive të komunës. Gjatë periudhës së raportimit, ministria filloi me zbatimin e një strategjie të re për mbikëqyrjen e mbledhjeve të kuvendeve komunale me anë të transmetimit elektronik (*online*). Ky mekanizëm i ri i mbikëqyrjes është i rregulluar me anë të Udhëzimit administrativ nr. 2012/01 për monitorimin e kuvendeve komunale përmes teknologjisë informative – teleprezencës.

³ Komunat Zvečan/Zveçan, Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok nuk janë të përfshira në këtë vlerësim.

2. MBLEDHJET E KUVENDEVE KOMUNALE – GJETJET KRYESORE

Siç përshkruhet në hollësi në raportin e OSBE-së të vitit 2011⁴, korniza rregullatore në Kosovë përcakton, ndër të tjera, që vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektshmërisë, respektimit të sundimit të ligjit dhe përafrimit e vendimmarrjes më afër banorëve për të promovuar qeverisjen e qëndrueshme.⁵ Për më tepër, Ligji për vetëqeverisjen lokale garanton këto parime dhe përcakton rolin kyç të kuvendit të komunës si një organ ligjvënës të komunës përgjegjës për marrjen e vendimeve në lidhje me çështjet e rëndësishme komunale⁶ dhe për mbikëqyrjen e punës së degës ekzekutive. Prandaj ai përvijon aspektet kyçe zyrtare për funksionimin e një organi të tillë të rëndësishëm. Kjo përfshin dispozitat për njoftimin e mbledhjeve të hapura për opinion, parandalimin e situatave të konfliktit të interesit, si dhe dispozitat për sigurimin e përkthimit me gojë dhe me shkrim në lidhje me veprimtaritë e kuvendeve komunale.

Në këtë pjesë paraqiten gjetjet kryesore të veprimtarive monitoruese të OSBE-së në lidhje me nivelin e respektimit të kërkesave zyrtare të lartcekura. Aty gjithashtu paraqitet gjendja e tanishme dhe zhvillimet në fushën e mbikëqyrjes të veprimtarive të kuvendeve komunale nga ana e ministrisë.

2.1 Njoftimi për mbledhjet

Një prej mangësive procedurale që u identifikua në raportin e OSBE-së të vitit 2011⁷, në afro gjysmën e komunave që u nënshtuan vlerësimit, ishte dështimi për ta njoftuar opinionin për mbledhjet e radhës⁸ dhe mosarritja e një sensibilizimi mjaft të gjerë të opinionit.⁹ Dështimi në lehtësimin e qasjes së opinionit të gjerë në proceset e vendimmarrjes pengon përpjekjet e institucioneve komunale për të qeverisur në mënyrë transparente, gjë që përbën shkelje të parimeve të qeverisjes së mirë të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Gjetjet më të fundit të veprimtarive monitoruese të OSBE-së zbulojnë që vetëm tri komuna dështuan në më shumë se një rast, që të shpallin njoftimin publik para mbledhjeve të kuvendeve komunale.¹⁰ Të gjitha 31 komunat e tjera shpallën me kohë

⁴ Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010*, <http://www.osce.org/kosovo/80664>, (qasur më 14 nëntor 2011).

⁵ Preambula e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 4 qershor 2008.

⁶ Neni 40.2 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

⁷ Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010*.

⁸ Respektimi i parimit të takimeve të hapura është i rregulluar kryesisht me anë të nenit 45 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ku përcaktohet se të gjitha takimet e kuvendit të komunës janë të hapura, megjithëse ka disa përjashtime.

⁹ Ligji për vetëqeverisjen lokale ia përcakton detyrimin komunave për t'i njoftuar me kohë dhe në mënyrë efektive banorët për mbledhjet e radhës të kuvendit të komunës, ndërsa Udhëzimi administrativ 2008/09 për transparencën në komuna, me anë të së cilit zbatohet ligji, përkufizon mënyrat se si duhet të njoftohet opinioni për veprimtaritë e degës ligjvënëse, p.sh., informata duhet të vendoset në vendet më të vizituara në komunë në përputhje me nenin 3.3 të Udhëzimit administrativ 2008/09.

¹⁰ Mamuša/Mamushë/Mamuša në dy raste; Suharekë/Suva Reka në katër raste; Rahovec/Orahovac në pesë raste. Përveç kësaj, komunat Deçan/Dečane, Prishtinë/Priština Gračanica/Gračanicë, Štrpce/Shtërpçë, Gjilan/Gnjilane dhe Klokot/Kllokot dështuan që ta shpallin njoftimin për takim në një rast.

mbledhjet e kuvendeve komunale.¹¹ Kjo shënon një përparim të konsiderueshëm në krahasim me 16 komunat e raportuara më herët që dështuan ta respektojnë këtë detyrim në më shumë se një rast.¹²

Sa i përket mjeteve që përdoren për ta njoftuar opinionin për mbledhjet e radhës të kuvendeve komunale, komunat vazhdojnë që të përdorin tabelat komunale të njoftimeve dhe ueb faqet zyrtare të komunës për shpërndarjen e informacionit. Megjithatë 15 komuna përdorën edhe mjete tjera, duke dëshmuar kështu një përpjekje shtesë për ta sensibilizuar opinionin.¹³ Për shembull, komunat Pejë/Peć, Deçan/Dečane, Glllogoc/Glogovac dhe Mitrovicë/Mitrovica vendosën informata për veprimtaritë e kuvendeve komunale në vendet më të vizituara të komunës, të tilla si qendra urbane. Një risi tjetër në lidhje me sensibilizimin e opinionit u ndërmor nga komuna e Prishtinës/Priština, e cila lëshoi deklaratat për shtyp përkitazi me veprimtaritë e ardhshme ligjvënëse. Shpalljet në radio, pllakat dhe afisheet gjithashtu janë cekur si mjet për shpërndarjen e informacionit për mbledhjet e radhës.¹⁴

Për më tepër, vlerësimi tregon që pjesëmarrës publikë ishin të pranishëm në 95 për qind të mbledhjeve të monitoruara të kuvendeve komunale; megjithatë, pjesëmarrja shpeshherë ishte e nivelit të ulët.¹⁵ Përveç kësaj, publiku nuk ishte fare i pranishëm në të gjitha 18 mbledhjet e monitoruara në katër komuna gjatë periudhës së raportimit.¹⁶ Numri më i lartë i anëtarëve të opinionit të pranishëm u vërejt në komunat Pejë/Peć, Prizren, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Rahovec/Orahovac, Kaçanik/Kaçanik dhe Lipjan/Lipljan.¹⁷

Në përgjithësi, kërkesa për shpalljen publike të mbledhjeve të kuvendeve komunale u përmbush në shumicën e komunave, gjë që shënon një përmirësim në krahasim me raportin e mëparshëm të OSBE-së. Përveç kësaj, gjysma e komunave ndërmorën përpjekje shtesë për ta sensibilizuar dhe njoftuar opinionin, gjë që paraqet një trend pozitiv. Niveli i pjesëmarrjes së opinionit nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm, duke qenë se është vazhdimisht në nivele të ulta në shumë komuna. Përpjekjet e vazhdueshme për ta shtuar efikasitetin e shpalljeve publike të mbledhjeve të kuvendeve komunale mund ta rrisë pjesëmarrjen e opinionit dhe në këtë mënyrë ta përmirësojë transparencën e veprimtarive ligjvënëse komunale.

¹¹ Së paku shtatë ditë punë para ditës së mbledhjes për mbledhjet e zakonshme, nenet 43.3 dhe 45.2 të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale.

¹² Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010* (faqe 7).

¹³ Prizren, Shtime/Štimlje, Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Deçan/Dečane, Novo Brdo/Novobërdë, Ranilug/Ranillug, Kamenica/Kamenicë, Prishtinë/Priština, Glllogoc/Glogovac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn.

¹⁴ Në vitin 2010 dhe 2011, OSBE-ja i dhuroi përafërsisht 3.000, përkatësisht 4.000 afishe komunave për shpalljen e mbledhjeve të kuvendeve komunale.

¹⁵ Numri më i ulët i pjesëmarrjes së opinionit u shënuar në komunat në vijim: Dragash/Dragaš (më së paku 2, më së shumti 8 persona), Gračanica/Gračanicë (më së paku 1, më së shumti 6 persona), Junik (më së paku 2, më së shumti 9 persona), Vushtrri/Vučitrn (më së paku 4, më së shumti 6 persona) dhe Skenderaj/Srbica (më së paku 3, më së shumti 5 persona).

¹⁶ Štrpce/Shtërpçë, Parteš/Partesh, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić.

¹⁷ Pejë/Peć (më së paku 4, më së shumti 20 persona), Prizren (më së paku 11, më së shumti 60 persona), Gjakovë/Đakovica (më së paku 3, më së shumti 28 persona), Klinë/Klina (më së paku 3, më së shumti 30 persona), Rahovec/Orahovac (më së paku 3, më së shumti 25 persona), Kaçanik/Kaçanik (më së paku 2, më së shumti 25 persona) dhe Lipjan/Lipljane (më së paku 2, më së shumti 12 persona).

2.2 Parandalimi i konfliktit të interesit

Në krahasim me gjetjet e paraqitura në raportin e OSBE-së të vitit 2011, kuvendet komunale dështuan, në masë të konsiderueshme, që ta adresojnë çështjen e konfliktit të interesit gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale.

Secili deputet i kuvendeve komunale, i cili e gjen veten në një situatë të konfliktit të interesit, përjashtohet nga procesi i vendimmarrjes në lidhje me cilëndo çështje në të cilin ai/ajo, apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes, ka interes financiar apo çfarëdo tjetër. Anëtarët e kuvendit janë të obliguar që t'i regjistrojnë deklaratat e hapura për interesat e tyre financiare para seancës inauguruese të kuvendit të komunës dhe që të raportojnë për çfarëdo ndryshimi të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.¹⁸ Ata janë njëjloj të obliguar që të shpalojnë çfarëdo konflikt të interesit, personal a financiar, që mund të lind gjatë ushtrimit të mandatit të anëtarit të kuvendit të komunës. Po ashtu, secili anëtar i kuvendit të komunës mund të ofrojë informata për interesat e mundshme të anëtarit tjetër. Komunave u kërkohet që të përcaktojnë procedurat për përjashtimin e anëtarëve nga vendimmarrja aty ku kanë konflikt interesi, si dhe procedurat administrative në statutet e tyre komunale dhe rregulloret e punës të kuvendeve komunale.

Vlerësimi tregon se çështja e konfliktit të interesit u adresua vetëm në dy komuna: në një rast nga kryesuesi në komunën e Glogocit/Glogovac,¹⁹ dhe në komunën e Pejës/Peć ku kryesuesi rregullisht pyet anëtarët e kuvendit të komunës nëse ndonjë prej pikave të rendit të ditës ka mundësi që të shkaktojë konflikt interesi. Në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit, kjo shënon një rënie të konsiderueshme të numrit të rasteve në të cilat çështja e konfliktit të interesit u ngrit në komuna.²⁰

Siç u cek më lartë, komunave u kërkohet që të përcaktojnë procedurat për përjashtimin e anëtarëve nga vendimmarrja aty ku kanë konflikt interesi, si dhe procedurat administrative në statutet e tyre komunale dhe rregulloret e punës të kuvendeve komunale.²¹ Vetëm dy komuna, Lipjan/Lipljan dhe Shtime/Štimlje, plotësuan këtë kërkesë dhe përkufizuan procedurat e konfliktit të interesit në aktet e lartcekura komunale.²²

Sipas ligjit komunat janë të detyruara që të rregullojnë çështjen e konfliktit të interesit.²³ Përkufizimi i procedurës së përjashtimit të anëtarëve të kuvendeve komunale, të cilët kanë konflikte të interesit, i mban ata përgjegjës për veprimet e tyre të vendimmarrjes. Për më tepër, ajo shton nivelin e vetëdijesimit të anëtarëve të

¹⁸ Neni 38 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale rregullon çështjen e konfliktit të interesit për anëtarët e kuvendeve komunale dhe pasqyron standardet ndërkombëtarë, të tilla si llogaridhënia.

¹⁹ Në mbledhjen e kuvendit të komunës së Glogocit/Glogovac, e cila u mbajt më 26 maj 2011, kryesuesi kërkoi nga disa anëtarë të kuvendit që ta lëshojnë mbledhjen për shkak se ai besonte se ata kishin konflikt interesi me pikën e rendit të ditës për atë mbledhje të kuvendit të komunës.

²⁰ Sipas vlerësimit të mëparshëm, çështja e konfliktit të interesit u ngrit 12 herë në gjashtë komuna. Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010* (faqe 7).

²¹ Neni 38 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

²² Për shembull, neni 18.2 i rregullores së punës së komunës të Lipjanit/Lipljan përkufizon në mënyrë të qartë detyrimin e kryesuesit për të pyetur anëtarët e kuvendit të komunës nëse kanë ndonjë konflikt të mundshëm të interesit.

²³ Neni 38 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

kuvendeve komunale në lidhje me çështjen në fjalë. Në këtë aspekt, praktikat e komunave të lartcekura duhet të merren parasysh nga komunat e tjera.

2.3 Sigurimi i përkthimit me shkrim dhe me gojë

Në bazë të kërkesës, përkthimi i njëkohshëm me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale sigurohet gati gjithmonë nga komunat. Sidoqoftë, përkthimi me shkrim i materialeve të mbledhjes së kuvendeve komunale nuk sigurohet fare nga 52 për qind e komunave që iu nënshtruan vlerësimit.²⁴

Në mënyrë që të sigurojë një transparencë dhe qasje më të madhe të veprimtarive ligjvënëse komunale, Ligji për vetëqeverisjen lokale përcakton që përdorimi i gjuhëve në komunë rregullohet në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe përmes një rregulloreje të hollësishme komunale.²⁵ Gjuhët zyrtare duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë dhe duhet të përdoren në punën e përditshme të komunave; përkthimi me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale duhet të sigurohet kur një gjë e tillë kërkohet nga një banor a anëtar i kuvendit të komunës, si dhe duhet të sigurohet përkthimi me shkrim i të gjitha materialeve të mbledhjes në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.²⁶

Vlerësimi tregon se me përjashtim të njëjës komunë²⁷, të gjitha komunat e tjera, në bazë të kërkesës, respektuan kërkesën ligjore për sigurimin e përkthimit të njëkohshëm me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendeve komunale.

Megjithatë dështimi për të përkthyer me shkrim dhe për t'i botuar materialet e mbledhjes së kuvendeve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare vazhdon të përsëritet në shumicën e komunave, siç u raportua edhe më herët.²⁸ Nga 34 komuna që u monitoruan, 21 nuk e përkthyen fare procesverbalin e mbledhjes. Vetëm gjashtë komuna përherë përkthyen materialet e mbledhjes në gjuhët zyrtare, kurse në komunat Gjilan/Gnjilane, Prizren dhe Klinë/Klina ky detyrim ligjor u respektua, përveç njëjës, në të gjitha mbledhjet e monitoruara të kuvendeve komunale²⁹ ndërsa komunat e tjera i përkthyen materialet në baza të parregullta.³⁰

Mosrespektimi i vazhdueshëm i dispozitave gjuhësore në lidhje me përkthimin e materialeve të mbledhjes mund të vështrohet si mungesë e gatishmërisë për të përkushtuar burime njerëzore dhe të tjera të nevojshme për të siguruar respektimin e kësaj kërkesë ligjore. Autoritetet mbikëqyrëse duhet t'ua kujtojnë komunave detyrimin e tyre ligjor për t'i përkthyer materialet e mbledhjes në të gjitha gjuhët zyrtare.

²⁴ Përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare në nivel komunal garantohet me kornizën ekzistuese ligjore.

²⁵ Neni 9 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

²⁶ Nenet 7.3 dhe 7.4 të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

²⁷ Mamuša/Mamushë/Mamuša.

²⁸ Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010*. Katërmbëdhjetë nga 34 komuna që u monitoruan e përkthyen procesverbalin e mbledhjes së kuvendeve komunale në gjuhët zyrtare të komunës.

²⁹ Parteš/Partesh, Dragash/Dragaš, Vushtrri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica, Pejë/Peć dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

³⁰ Klokot/Kllokot, Štrpce/Shtërpçë, Mamuša/Mamushë/Mamuša, dhe Prishtinë/Priština.

2.4 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – veprimtaritë e mbikëqyrjes

Si autoritet mbikëqyrës, ministria është përgjegjëse – ndër të tjera – për të siguruar ligjshmëri dhe legalitet të veprimtarive të organeve të qeverisë lokale.³¹ Prandaj ministria mbikëqyr mbledhjet e kuvendeve komunale, duke qenë e pranishme gjatë mbledhjeve apo përmes mbikëqyrjes elektronike (*online*).

Vlerësimi tregon që zyrtarët e ministrisë mbikëqyrën 155 mbledhje të kuvendeve komunale nga gjithsej 362 mbledhje që u vlerësuan nga OSBE-ja. Siç u raportua edhe më herët, zyrtarët e ministrisë ishin më së paku të pranishëm në rajonin e Pejës/Peç duke qenë se nuk kishte asnjë prani nga ministria në 46 nga 66 mbledhje. Përveç kësaj, vlerësimi më i fundit identifikoi mungesën e tyre të zgjatur në komunën e Podujevës/Podujevo.

Që nga janari i vitit 2012, ministria instaloi me sukses sistemin e transmetimit përmes ueb faqes të mbledhjeve të kuvendeve komunale. Përdorimi i këtij mjeti të mbikëqyrjes u rregullua me anë të një udhëzimi administrativ, i cili u nxor nga ministria, që përkufizon procesin e mbikëqyrjes përmes pajisjeve të teknologjisë informative dhe përgjegjësitë e nivelit qendror dhe atij lokal në këtë proces.³² Në përputhje me kornizën ligjore dhe parimet e qeverisjes së mirë, transmetimi elektronik (*online*) i mbledhjeve të kuvendeve komunale ka për qëllim përmirësimin e punës së autoriteteve lokale. Përveç kësaj, ai duhet t'i mundësojë ministrisë që të jetë më efikase gjatë mbikëqyrjes përderisa ul shpenzimet.

Si ministria, ashtu edhe komunat që iu nënshtruan vlerësimit për këtë raport, deklaruan që mjeti elektronik i mbikëqyrjes po zbatohet pa pengesa të mëdha. Me përjashtim të gjitha mbledhjeve të kuvendeve komunale që u mbajtën në tri komuna, të gjitha mbledhjet e tjera të kuvendeve komunale u transmetuan në mënyrë elektronike (*online*).³³

Që nga fillimi i zbatimit të këtij mjeti, ministria ka qenë në gjendje që të mbikëqyrë mbledhjet e kuvendeve komunale në shumicën dërmuese të komunave. Në lidhje me komunat dhe detyrimet e tyre për ta bërë funksional mbikëqyrjen elektronike (*online*), 12 komuna ende nuk kanë pranuar të gjitha pajisjet e nevojshme³⁴, siç përcaktohet me udhëzimin administrativ që rregullon transmetimin e kuvendit komunal.³⁵ Aktualisht këto komuna po përdorin vetëm pajisjet e tyre ekzistuese të kufizuara komunale.³⁶

Vlen të theksohet bashkëpunimi i mirë në mes të nivelit qendror dhe lokal gjatë përgatitjeve për futjen në përdorim të sistemit elektronik të mbikëqyrjes, gjë që u

³¹ Neni 76 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

³² Udhëzimi administrativ nr. 2012/01 për mbikëqyrjen e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative – teleprezencës, i miratuar nga MAPL më 17 janar 2012.

³³ Për shkak të mungesës së lidhjes së Internetit me MAPL, nuk u transmetuan në mënyrë elektronike mbledhjet e kuvendeve komunale së Gračanica/Graçanicës, Deçanit/Deçane and Parteš/Parteshit.

³⁴ Një kompjuter portativ dhe së paku dy mikrofon të veçantë për mbikëqyrjen elektronike.

³⁵ Nenet 5.2 dhe 9.4 të UA nr. 2012/01 të MAPL-së për mbikëqyrjen e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve TI.

³⁶ Komunat Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština, Malishevë/Mališevo, Dragash/Dragaš, Viti/Vitina, Parteš/Partesh, Glllogoc/Glogovac, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica nuk kanë kompjuterë të veçantë për qëllime të mbikëqyrjes elektronike. Përveç kësaj, komunat Gračanica/Graçanicë, Kaçanik/Kaçanik dhe Ferizaj/Uroševac raportuan mungesë të mikrofonave.

vërtetua nga të gjitha komunat që iu nënshtruan vlerësimit dhe zyrtarët e ministrisë dhe kjo po ashtu përcaktohet me anë të udhëzimit administrativ.³⁷

Aktualisht ministria po punon në zgjerimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike për t'ju mundësuar banorëve qasje në mbledhjet e degës ligjvënëse të komunës. Më vonë gjatë vitit 2012 pritet që komunat do të jenë në gjendje që t'i lidhin ueb faqet e tyre zyrtare me sistemin e mbikëqyrjes elektronike për të mundësuar transmetimin publik të mbledhjeve të kuvendeve komunale.³⁸ Transmetimi i mbledhjeve të kuvendeve komunale përmes ueb faqes ka potencialin që të drejtojë procedurat dhe që të përmirësojë qasjen dhe transparencën e veprimtarive të degës legjislative të komunës, duke iu mundësuar banorëve qasje në veprimtaritë e degës legjislative të komunës.

3. PËRFUNDIMET

Raporti tregon për përparimin e shënuar në nivelin e respektimit të dispozitave të kornizës ligjore në Kosovë për mbarëvajtjen e veprimtarive të kuvendeve komunale. Disa praktika të kuvendeve të komunave do të duhej të përdreshin si shembuj të praktikave më të mira. Sidoqoftë, ende ka disa mangësi në një numër të konsiderueshëm të komunave.

Kërkesa ligjore për shpalljen publike të mbledhjeve të kuvendeve komunale plotësohet në shumicën e komunave, me një numër në rritje të komunave që respektojnë kërkesën ligjore për shpalljen me kohë dhe në mënyrë efektive të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Ky është një përmirësim i dukshëm në krahasim me numrin e komunave që nuk shpallën mbledhjet e kuvendeve komunale, siç u identifikua në raportin e OSBE-së të vitit 2011.³⁹ Përveç kësaj, 44 për qind e komunave që iu nënshtruan vlerësimit ndërmorën përpjekje shtesë për njoftimin e mbledhjeve, duke vendosur kështu praktikën më të mira që duhet të ndiqen nga komunat e tjera. Megjithatë vazhdon mungesa apo pjesëmarrja e ulët e opinionit në mbledhjet e kuvendeve të komunave.

Një prej mangësive është mungesa e masave të ndërmarra për të adresuar situatat e mundshme të konfliktit të interesit, gjë që u vërejt në 84 për qind të komunave që iu nënshtruan vlerësimit. Megjithatë, si një aspekt pozitiv, Misioni identifikoi dy komuna në të cilat procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit janë të përcaktuara me statutet e komunave dhe rregulloret e punës të kuvendeve komunale. Ndonëse një numër simbolik, këto dy komuna me procedurat e përcaktuara ka gjasa të shënojnë një trend në rritje të vetëdijesimit për rëndësinë e adresimit të çështjes së situatave të konfliktit të interesit.

Megjithëse gati të gjitha komunat sigurojnë shërbime të përkthimit me gojë, nuk sigurohet përkthimi me shkrim i materialeve të mbledhjeve të kuvendeve komunale në gjuhët zyrtare, ashtu siç përcaktohet me kornizën rregullatore. Përfundimisht,

³⁷ Para fillimit të secilës seancë të kuvendit të komunës, komuna duhet t'i jap ministrisë të drejtat e qasjes për mbikëqyrje elektronike (nenet 7 dhe 8 të UA nr. 2012/01 të MAPL-së për mbikëqyrjen e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve TI). Deri më tani nuk ka pasur probleme me lehtësinë e qasjes së tillë.

³⁸ Informatë nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të departamentit të vetëqeverisjes lokale të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

³⁹ Shih Raportin e OSBE-së të vitit 2011, *Raporti i monitorimit të kuvendeve komunale, mars 2009 – dhjetor 2010* (faqe 11).

mbikëqyrja elektronike e mbledhjeve të kuvendeve komunale po zbatohet me sukses në shumicën e komunave, duke rezultuar kështu me një mbarëvajtje më transparente të proceseve komunale të vendimmarrjes.

4. REKOMANDIMET

Për kuvendet e komunave:

1. Të zbatojnë praktikën më të mira për shpërndarjen e informatave për mbledhjet e radhës të kuvendit të komunës, duke vendosur njoftimin në vendet më të vizituara dhe/ose duke përdorur masmedian lokale.
2. Të përkufizojnë në mënyrë të qartë procedurat për mbikëqyrjen e konfliktit të interesit dhe t'i përfshijnë ato në statutet e komunës ose në rregulloret e punës të kuvendit të komunës. Praktikën më të mira përfshijnë respektimin e kërkesës së kryesuesit të kuvendit të komunës për të pyetur anëtarët e kuvendit të komunës, të pranishëm në mbledhje, nëse ndonjëri prej tyre gjendet në një situatë të konfliktit të interesit në lidhje me çështjet për të cilat merret vendim gjatë mbledhjes.
3. Komunitet të cilat nuk respektojnë dispozitat ligjore për përdorimin e gjuhëve, duhet t'i përkthejnë dhe botojnë materialet e mbledhjeve të kuvendit në të gjitha gjuhët zyrtare, siç përcaktohet me kornizën ligjore.
4. Të ruajnë bashkëpunimin e mirë të vendosur me nivelin qendror para dhe gjatë transmetimit elektronik të mbledhjeve të kuvendit të komunës.
5. Të sigurojnë pajisjet e nevojshme për të mundësuar mbikëqyrjen elektronike të mbledhjeve të kuvendit të komunës në ato pak komuna ku kjo gjë ende nuk është bërë.

Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal:

1. Të sigurojë respektimin e kornizës ligjore dhe të sundimit të ligjit, për shembull duke adresuar rastet e mosrespektimit.
2. Të përfundojë zgjerimin e sistemit aktual të mbikëqyrjes elektronike për t'ju mundësuar komunave transmetimin e mbledhjeve të mbikëqyrura të kuvendeve komunale në ueb faqet e komunave.